

**Emër Mbiemër:** Dhimitër Haxhimihali

**Datëlindje:** 22.04.19541

**Vendlindje:** Vlorë, Shqipëri

**Viti i zgjedhjes:** 2003 (akademik)

**Seksioni:** Shkencat natyrore dhe teknike

**Gjuhët:** Anglisht, Rusisht, Italisht

**Kontakt:**



---

**Adresa:** Sheshi Fan Noli Nr 7, Tiranë

**Telefon:** +355 68 221 1851

**Email:** dhimiterh@yahoo.com

**Faqe zyrtare:** [www.akad.gov.al](http://www.akad.gov.al)

### **CV e shkurtër**

Lindi në Vlorë. Arsimin e mesëm e kreu në gjimnazin “Qemal Stafa” në Tiranë (1957). Studimet e larta i ndoqi në Institutin Kimiko-Teknologjik “Mendelejev” të Moskës (1957 – dhjetor 1961) ndërsa u diplomua në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës (1962) në degën e kimisë industriale. Po atë vit u emërua pedagog në katedrën e teknologjisë kimike inorganike në Fakultetin e Shkencave Natyrore; në vitet 1990–2007 ka qenë përgjegjës i Seksionit të Teknologjisë Kimike. Ka kryer kualifikime e specializime pasuniversitare në disa qendra universitare e kërkimore në Kinë, Itali, Angli, Gjermani.

Dhimitër Haxhimihali ka dhënë ndihmesë në zhvillimin e përparimin e procesit mësimor në degën e kimisë industriale të Universitetit të Tiranës, si drejtues lëndësh, hartues planesh e programesh mësimore të nivelit universitar e pasuniversitar. Ka kryer dhe drejtuar një varg studimesh në fushën e pasurimit të lëndëve të para fosfatike të vendit, të përpunimit të lëndëve fosfatike në plehra kimike, në fushën e ruajtjes e të mbrojtjes së mjedisit, të prodhimit të pastër etj.; ka trajtuar gjithashtu çështje të terminologjisë së kimisë në gjuhën shqipe. Në këto fusha ka drejtuar projekte e grupe kërkimore si dhe

një numër disertantësh për fitimin e gradës "doktor i shkencave". Ka marrë titullin shkencor profesor më 1994. Më 2003 u zgjodh anëtar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe në periudhën 2009 – 2014 ka drejtuar Seksionin e Shkencave Natyrore e Teknike në ASHSh. Është autor i një numri të konsiderueshëm artikujsh, kumtesash e referatesh shkencore brenda e jashtë vendit, si dhe i një vargu tekstesh universitare e monografish. Ka qenë hartues zërash në fushën e kimisë në "Fjalorin enciklopedik shqiptar" (botim i v. 1985), si dhe autor zërash, anëtar i redaksisë së përgjithshme dhe përgjegjës i redaksisë së matematikës, fizikës, kimisë, informatikës për botimin e ri të "Fjalorit enciklopedik shqiptar" (2001–2009).

### **Veprat kryesore**

*Teknologjia kimike inorganike*, tekst universitar, 1971, 1987, 2005.

*Fjalor i kimisë*, 1984 (bashkautor).

*Teknologjia kimike e mjedisore*, tekst universitar, 2002 (bashkautor).

*Histori e prodhimit kimik në Shqipëri*, ASHSH, 2010.

*Kimia Industriale I*, tekst universitar, 2011.

*Konferenca kombëtare e kimisë: "Kimia dhe zhvillimi aktual i vendit", Libri i Punimeve (Proceedings)*, (editor i punimeve) ASHSH, 2011.

*Trajtimi i ujërave të shkarkimeve industriale e urbane*, tekst universitar, 2014 (bashkautor).

*Njehsime dhe probleme të kimisë industriale*, tekst universitar, 2015.

*Fjalor i termave bazë të kimisë: shqip-anglisht, anglisht-shqip*, ASHSH, 2019 (bashkautor e bashkëredaktor).